



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion;

Mbledhja nr. 10 / 2008;
më 06.05.2008, në ora 11:00;
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225.

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha-Shala, Múfera Şinik, Zef Morina dhe Berim Ramosaj;

Munguan: Et'hem Çeku, Slobodan Petroviq, Kaqusha Jashari dhe Fatmir Rexhepi;

Përcjellës prezent: Haxhi Gashi nga USAID-i dhe Lejla Selimi nga OSBE-ja;

Nga zyra mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina dhe Besim Haliti;

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani – Kryetare e Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë për Energjetikë dhe Miniera për tërheqjen e tri ligjeve nga procedura e shpalljes (Projektligji për miniera edhe minerale, Projektligji për hulumtimet gjeologjike, dhe Projektligji për ngrohje qendrore);
3. Të ndryshme;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

I - Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua pa vërejtje.

II. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë për Energjetike dhe Miniera lidhur për tërheqjen e tri projektligjeve nga procedura e miratimit (Projektligji për miniera edhe minerale, Projektligji për hulumtimet gjeologjike, dhe Projektligji për ngrohje qendrore);

Kryetarja – paraqiti kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Minerave (më poshtë MEM-i), për tërheqjen e tri projektligjeve, të miratuara nga Kuvendi por të pa nënshkruara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (më poshtë PSSP-ja).

Ajo njoftoi se i është bërë ftesë ministrit të MEM-it që të marr pjesë në këtë mbledhje dhe me arsyetua më hollësisht arsyen e parashtrimit të kërkesës për tërheqje. Gjerë me tani nuk kemi marrë informatë për arsyesmerinë e mos pjesëmarrjes.

Ligji për ngrohje qendrore është shqyrtua në këtë komision para disa ditësh sipas vërejtjeve të UNMIK-ut dhe është procedua në Kryesi të Kuvendit për procedim të mëtejme çka mendojë se nuk kemi të drejtë si dhe arsye që tani të meremi përsëri edhe më tej me këtë ligj.

Me këtë mendim u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të komisionit.

Berim Ramosaj – theksoj se me siguri qëndron arsyeja e MEM-it për tërheqjen e këtyre Ligjeve të pa shpallura e që sipas tij rëndësia e shpalljes së tyre është shumë e madhe por duhet konsultua kompetentët dhe juristët për mundësinë e tërheqjes apo të një zgjidhjeje sa ma të pranueshme. Unë jam për tërheqje apo shpallje të tyre sa ma parë por problemi qëndron në gjetjen e formës procedurale të tërheqjes.

Haki Shatri – ishte i mendimit që të kërkohet shpallja e me njëhershme e këtyre ligjeve e pastaj në qoftë së kompetentët mendojnë se ka nevojë për ndryshim e plotësim të ligjeve në fjalë, të fillojë procedura e rregullt e ndryshimit . Mendojë se kjo është zgjidhja më e mirë dhe më e shpejtë që Kosova të ketë këto ligje të cilat mendojë se janë ndër ligjet më të rëndësishme.

Sala Brisha-Shala – tha se ekziston një rregull në Rregulloren e Kuvendit, që ligjet e pa përfunduara dhe të pa nënshkruara nga PSSP-ja kthehen në pikën e fillimit dhe përsëri duhet të fillojnë që nga e para. Ashtu duhet të veprohet edhe në rastin konkret dhe të mos pritët më shumë sepse ekonomisë dhe energjetikës së Kosovës po i kushton shumë mungesa e këtyre ligjeve. Arsyeja e mos shpalljes supozohet duke shtuar se të këto dy ligje që rregullojnë fusha te rezervuara për UNMIK-un me qëllim është zvarritur shpallja e tyre vetëm e vetëm për të realizua interesa të veta në dëm të Kosovës.. Tani pas

shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe miratimit të Kushtetutës kanë ndryshuar rrethanat politike andaj mendoj se më të drejtë ministria ka kërkuar që të tërhiqen këto ligje nga shpallja me qëllim të rihartimit ma të mirë, sepse PSSP-ja as që mendon për shpalljen e tyre.

Zef Morina – theksoj së UNMIK-u, ka gati tri vite që i ka bllokuar këto ligje me mos shpallje dhe mendoj se qëllimi është i natyrës politike. Ai aksentin e diskutimit e përqendroi në rëndësinë ekonomike të këtyre ligjeve (Ligjit për miniera e minerale dhe Ligjit për hulumtime gjeologjike). Sipas tij i tërë potenciali ynë është dashur dhe duhet orientuar në gjetjen e formës me ndikim për shpalljen ose kthimin e tyre për plotësim e ndryshim. Sipas tij po të shpalleshin pastaj plotësimi dhe ndryshimi i tyre nëse dot ishte e nevojshme dot zhvillohej procedurë përkatëse. Nëse këto ligje PSSP-ja, nuk i dekreton deri më 15 qershor, mendojë se sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës kalojnë në kompetencë të Presidentit kur edhe do ti shpall. Sipas tij më mirë është që të ndikohet të PSSP-ja dhe të shpallen ligjet e përmendura sesa të kërkohej që të tërhiqen sepse sipas rregullave për procedura, PSSP-ja si duket nuk do ti përgjigjet kërkesës për kthimin e tyre.

Safete Hadergjonaj – tha se vendi ynë ka nevojë shumë për këto ligje, mirëpo nuk kemi nevojë për ligje të pa implemetueshme. Sipas saj këto ligje të dërguara për shpallje duhet të tërhiqen për ri hartim sepse nuk plotësojnë shumë kërkesa e nevoja .

Mos shpallja e këtyre ligjeve është politike, ndërsa MEM-i ka arsye përmbajtjesore për tërheqjen e tyre. Ajo tha se nuk shoh asgjë të keqe që këto ligje të kthehen në qeveri ku ndoshta më shpejtë dot përfundojë miratimi i tyre se sa të kthehen nga PSSP-ja me sugjerime për plotësime ndryshime. Tërheqja dhe rihartimi i këtyre ligjeve është zgjidhja më e mirë e mundshme për momentin përfundoi Hadërgjonaj.

Haxhi Gashi (përfaqësues i USAID-it) – theksoj se kanë ndryshuar rrethanat politike, ndërsa këto ligje janë hartua krejt në rrethana tjera, pra janë hartua nën influencën e UNMIK-ut. Ai tha se është qëndrim i zyrës së USAID-it, që të harmonizohen sa ma qartë qëndrimet lidhur me këto ligje e sidomos me projektligjin për miniera dhe minerale. Ai tha se kjo është çështje e ndjeshme dhe ka nevojë më u ri definua shumë raporte brenda këtyre ligjeve. Sipas tij kërkesa për shpallje ose kthim të këtyre ligjeve nga PSSP-ja vetëm sa do ta zvarris këtë çështje. Ndërsa në Qeveri ky afat mund të jetë dy deri tre muaj dhe pastaj i kthehet Kuvendit, për lexim dhe pastaj Kuvendi merret me procedura të mëtejshme. Ai tha se është më lehtë për Kuvendin, më ia kthye qeverisë me i ri hartua se sa me u marr me procedura të UNMIK-ut, nga se komisioni duke i harmonizua amendamentet e veta do të këtë shumë punë dhe do t'i duhej shumë kohë. Andaj është më mirë që ligjet të tërhiqen dhe qeveria të merret me ri hartimin e këtyre ligjeve dhe ta zgjidh këtë punë e jo Kuvendi.

Berim Ramosaj – tha se duke u mbështetur nga ato fakte që i theksoj përfaqësuesi i USAID-it, unë jamë për kthimin e të projektligjeve në qeveri por vetëm të gjendet forma procedurale.

Haki Shatri - tha se PSSP-ja nuk i ka nënshkruar ato ligje sepse nuk ka dashtë me i' a bart kompetencat e veta qeverisë në fushat e minierave, ku automatikisht i vazhdohet jeta Rregullores. Sipas tij shumë më mire është më kërkua që ai t'i shpall ligjet ose pas 15.06.2008 Presidenti i Kosovës do t'i shpall ligjet sipas kompetencës. Nëse ligji ka zbrazësi mund të fillojë amendamentimi e pastaj janë vetëm dy muaj procedurë në Kuvend, kurse rikthimi i tyre së paku do të merr kohë prej gjashtë muaj. Sipas tij përmbajtja e ligjit ka qenë jo e keqe, por PSSP-ja nuk i ka shpallur sepse nuk ka dashtë më i dal kompetencat jashtë dore. Sipas tij PSSP-ja s'po i nënshkruan ligjet, nga se i duken shumë të mira për institucionet vendore, ndërsa qeveria po kërkon më i terheqë për t'i bërë më të mira. Më mirë pra është të kërkohet që ligjet ose të shpallen e nëse jo atëherë të kthehen me sugjerime për plotësime.

Hasan Tahiri (nga zyra mbështetëse e Komisionit) - i njoftoi të pranishmit me rregullat procedurale për tërheqjen e ligjeve. Sipas tij ekziston vakum juridik lidhur me mundësin e tërheqjes së ligjeve-akteve të miratuara, dhe të proceduara në zyrën e PSSP-së për shpallje. Rregulla 63 e Rregullores së punës, i trajton të përfunduara veprimet e Kuvendit me skadimin e mandatit të Kuvendit- legjislaturës, duke mos përfshirë rastet e proceduara në zyrën e PSSP-së, për shpallje. Ai tha se ligjet e miratuara dhe të dërguara për shpallje gjinden nën autoritetin e PSSP-së. Nuk ka afat për shpallje apo kthim si dhe për t'i mbajtur nuk ka kufizime. Sipas tij, pasi mungon baza juridike për tërheqjen e ligjeve, e vetmja mundësi është të negociohet dhe gjendet paraprakisht një zgjidhje politike në mesë përfaqësuesve të Institucioneve- Kuvendit në njërën anë dhe të Zyrës së PSSP-së, e që do duhej të rezultonte ose me shpallje ose me kthim të ligjeve për plotësim e ndryshim. Mundësia tjetër është të pritet deri të hynë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe të veprohet sipas saj.

Haxhi Gashi (USAID) – tha se meqenëse ligjet nuk kanë hy në fuqi (nuk janë shpallur) nuk ka problem që të kthehen prapa, po të kish hy në fuqi do të merreshin forma tjera siç është plotësimi dhe ndryshimi.

Safete Hadergjonaj – ishte e mendimit se duhet të nxirret rekomandim me të cilin të kërkohet gjetja e procedurave (zbratësirave juridike) dhe ligjet të kthehen në qeveri për ri hartim.

Kryetarja në bazë të diskutimeve vërejti se shumica janë për miratim të kërkesës për kthimin e dy ligjeve për miniera ndërsa për ligjin për ngrohje jo, andaj propozoi këtë:

Përfundim

Komisioni, nuk pajtohet me kërkesën e tërheqjes së Ligjit për ngrohje qendrore sepse i njëjti është korrigjua sipas kërkesave të UNMIK-ut dhe është procedua në Kryesi për procedim të mëtejshëm ndërsa ,
Pajtohet me kërkesën e Ministrisë për tërheqjen e Ligjit për miniera e minerale dhe të Ligjit për hulumtime gjeologjike nga procedura e shpalljes, andaj nxori këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Kosovës që të procedojë me kërkesën e MEM-it për tërheqjen e:

Ligjit për miniera e minerale nr. 02/L-55 i miratuar me 19.01.2006 dhe të,

Ligjit për hulumtime gjeologjike nr. 02/L-82 i miratuar me 10.10.2006 nga procedura e shpalljes.

Komisioni u pajtua një zëri me këtë rekomandim.

III – Të ndryshme;

Kryetarja – propozoi që me 15.05.2008 të realizohet një vizitë pune në KEK, në Termocentralin “ Kosova B”.

Komisioni u pajtua me këtë propozim dhe :

Komisioni më 15 maj 2008, (të ënjtën) në ora 10:00, niset për në vizitë pune në KEK-ut dhe “Kosova B”

Mbledhja përfundoi në orën 12:30;

Kryetare e Komisionit:
Myzejene Selmani